

ELBER SHPK

Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2019

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Te dhena te pergjithshme mbi Shoqerine

Shoqeria **ELBER sh.p.k.** me NIPT K13621201W eshte person juridik shqiptar, e regjistruar me Vendim te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Nr. 24764 date 12.07.2000, me kapital themeltar 83.000.000 leke, i investuar teresisht nga ortakut i vetem i saj qe eshte Ministria e Ekonomise. Shoqeria Elber Sh.p.k. ka seline ne Elbasan, ne adresen: L: Dyli & Haxhire Myzyri, ish NBSH, Elbasan. Objekti i aktivitetit eshte furnizimi me uje te pijshem dhe largimin e ujerave te zeza. Qe nga viti 2014, shoqeria Elber shpk e nuk e ushtron kete aktivitet pasi me themelimin e UKE ne varesi te Bashkise Elbasan, te gjitha aktivitet afatgjate ia kaloi kesaj shoqerie me vendim te ortakut te vetem te Administrator i shoqerise Elber Sh.p.k. eshte **zj. Ledia Kollcinaku**.
Numri mesatar i punonjesve per vitin **2019** eshte **2** persona.

2. Baza e Pregatitjes se Pasqyrave Financiare

a. Menyra e Pregatitjes se Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), te cilat jane te aplikueshme per pasqyrat financiare qe mbulojne periudha duke filluar nga 1 janar 2008. SKK-te jane aplikuar prospektivisht nga 1 janar 2008 pa ndryshuar pasqyrat krahasuese te vitit 2007. Pasqyrat krahasuese te vitit 2007 jane pergatitur sipas Planit te Pergjithshem Kontabel (PPK), i cili perbehej nga rregulla dhe interpretime ne perputhje me ligjin 7661, date 19 janar 1993 "Mbi kontabilitetin" i zvendesuar nga ligji 9228, date 29 prill 2004 "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

b. Ndryshime ne metodat e vleresimit kontabel

Rishikimi i vleresimit kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi (cmuarja) eshte kryer dhe ne cdo periudhe qe preket ne te ardhmen.

c. Monedha Funksionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e Shoqerise. Informacioni financiar eshte paraqitur ne Leke.

d. Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshojë ne varësi të ketyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.



Në vecanti, informacion mbi fushtat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

ELBER Shpk

Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2019

3. Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel

a. Instrumenta financiar

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

i. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimë të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

ii. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

iii. Llogari të pagueshme



Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

iv. Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

ELBER Shpk

Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2019

v. Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, investimeve në pjesëmarrje, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

vi. Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

vii. Kapitali aksioner

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale. Aksionet e preferuara të detyrueshme me të drejtë riblerjeje klasifikohen si detyrime.

b. Veprimet ne monedha te huaja

Transaksioneve ne monedhe te huaj regjistrohen ne kontabilitet me kursin e dates se kryerjes se transaksionit.

Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj jane perkthyer ne pasqyren e bilancit me kursin e kembimit te Bankes se Shqiperise me 31.12.2019. Diferencat nga kursi i kembimit te lindura nga perkthimi njihen ne pasqyrene e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Asetet dhe detyrimet jo monetare qe maten me kosto historike ne monedhe te huaj perkthehen duke perdorur kursine kembimit ne daten e transaksionit.



Asetet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe paraqiten me vleren e drejte perkthehen me kursin e kembimit ne daten kur vlere e drejte eshte percaktuar.

Kursi i kembimit per dy monedhat e huaja kryesore me monedhen vendase sipas te Bankes se Shqiperise me 31.12.2019, ka qene respektivisht si me poshte:

1 Euro = 123.42 Lek

1 USD = 107.82 Lek

c. Vleresimin e Gjendjeve te Inventarit.

Inventaret regjistrohen ne kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle inventarin ne vendin dhe kushtet ekzistuese. Ne rastin e prodhimit te produkteve ne kosto perfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve te pergjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Koston e inventarit llogaritet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar

Gjendjet e Inventarit jane te vleresuara ne bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar kete vleresim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

ELBER Shpk

Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2019

d. Vleresimi Aktiveve Afatgjata Materiale

Aktivitet Afatgjata Materiale (AAM) paraqiten ne bilanc me vleren e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen ne kontabilitet me koston e marrjes ose te prodhimit te tyre.

Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle ate aktiv ne vendin dhe kushtet ekzistuese. Per llogaritjen e amortizimit jane aplikuar keto norma amortizimi:

Kategoria e AAM-ve	Norma e Amortizimit (%)		Metoda e Llogaritje
	2018	2017	
Ndertesa	5%	5%	Mbi vleren e mbetur
Instalime Teknike Specifike	5%	5%	Mbi vleren e mbetur
Instalime Teknike Komplekse	20%	20%	Mbi vleren e mbetur



Makineri e Paisje Pune	20%	20%	Mbi vleren e mbetur
Mjete transporti	20%	20%	Mbi vleren e mbetur
Mobilje dhe Paisje zyre	20%	20%	Mbi vleren e mbetur
Pajisje informatike	25%	25%	Mbi vleren e mbetur

e. Provizionet

Nje provizion krijohet nese ekziston nje detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve te kaluara; ekziston mundesia qe per shlyerjen e detyrimit dhe nese mund te beht nje vleresim relativisht i sakte i shumes se

f. Te Ardhurat

Te ardhurat regjistrohen sipas mases se realizimit te tyre dhe lidhjes qe ato kane me ushtrimin e mbyllur kontabel, pamvaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes. Te ardhurat nga interesat regjistrohen ne momentin e maturimit te tyre.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve te veta.

g. Tatimi mbi fitimin

Tatimi aktual mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me dispozitat e ligjit "Per tatimin mbi te Ardhurat ne Republiken e Shqiperise" duke perfshire gjithe detyrimet per tatimin mbi fitimin te pagueshme per vitin ushtrimor. Tatimet aktuale jane tatime per tu paguar qe rezultojne nga te ardhurat e tatueshme, duke perdorur shkallen tatimore qe eshte ne fuqi ne daten e bilancit, dhe çdo rregullim ne tatimet per tu paguar qe rrjedh nga vitet e kaluara.

Shkalla tatimore per tatimin mbi fitimin per vitin ushtrimor eshte **15%**.

h. Kontributet per Sigurimet dhe Fondi i pensioneve

Shoqeria paguan kontributet per pensione si edhe kontribute per sigurime shendetesore per punonjesit e saj sic eshte parashikuar ne legjislacionin social ne Shqiperi. Kontributet, bazuar ne pagat, jane paguar ne llogari te organizmave kombetare pergjegjes per pagesen e pensioneve dhe shpenzimeve shendetesore. Nuk ka asnje detyrim tjeter ne lidhje me fondin per pensione dhe shpenzime shendetesore.



ELBER Shpk**Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise**
Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2019

4 Mjete Monetare	2,019	2,018
	ALL	ALL
Deposita ne banke e llogari te tjera		13,572
Vlera ne Arke		0
		13,572
5 Aktive te tjera Financiare afatshkurter	2,019	2,018
(Të tjera)	ALL	ALL
Parapagim per tu kthyer		651,953
TVsh per tu marre nga Procesi Gjyqesor		11,683,839
TVSH per tu marre		188,391
		12,524,183
6 Detyrime afatshkurtra	2,019	2,018
(Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit)	ALL	ALL
Furnitore		0
Kreditore te ndryshem (Administratori)		3,282
		3,282
7 Detyrime afatshkurtra	2,019	2,018
(Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve)	ALL	ALL
Paga ndaj punonjesve		98,760
Sigurimet Shoqerore		76,962
		175,722
8 Detyrime afatshkurtra	2,019	2,018
(Të pagueshme për detyrimet tatimore)	ALL	ALL
Taksat vendore per vitin 2019		40,220
Tatim fitimi - periudha korente		
		40,220
9 Detyrime afatgjata	2,019	2,018
(Të tjera të pagueshme)	ALL	ALL
Kredi nga BWI		170,053,194
Kredi nga Rodeco		4,360,340
		174,413,534



Per kredite e marra nuk eshte llogaritur interes qe prej vitit 2013, si dhe per keto kredi nuk ka asnje kerkese nga ana e kreditoreve

ELBER Shpk

Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2019

Të ardhura të shtyra

	2,019 ALL	2,018 ALL
Të ardhura të shtyra		0
		0

Te ardhurat e shtyra perfaqesojne, te ardhurat e shtyra nga grantet e marra per invenstimet e kryera ne vite nga shoqeria. Meqenese ne vitin 2014 shoqeria ia kaloi te gjitha aktivet afatgjata (investimet e kryera) shoqerise UKE, sipas vendimit te ortakut te vetem te saj, keto te ardhura duheshin te merreshin si te ardhura ne pasqyren e te ardhurave - shpenzimeve qe ne vitin 2014. Sipas standarteve te kontabilitetit (SKKP 1, paragrafi 91), duke qene se ka kaluar nje periudhe e gjate prej 5 vjetesh, korrigjimi eshte bere ne menyre prespektive duke rregulluar tepricen e celjes te fitimive(humbje) te pashperndara (mbartura) per vleren e mesiperme. Shoqeria qe nga viti 2014 ka qene gjithmone me humbje, vlere e cila eshte me e madhe se te ardhurat qe duhej te paraqiteshin ne PASH ne vitin 2014, keshtu qe ky rregullim kontabel nuk sjell ndonje detyrim tatimor per shoqerine.

Provizione

	2,019 ALL	2,018 ALL
Provizione të tjera	0	0
	0	0

Provizionet perfaqesojne, provigjonimet e kryera ne vite nga shoqeria per klientet e saj. Meqenese ne vitin 2014 shoqeria ia kaloi te gjitha klientet shoqerise UKE, sipas vendimit te ortakut te vetem te saj, kushtet per cilat jane kryer keto provigjonime kane ndodhur qe ne vitin 2014, prandaj duheshin te merreshin si te ardhura ne pasqyren e te ardhurave - shpenzimeve qe ne vitin 2014. Sipas standarteve te kontabilitetit (SKKP 1, paragrafi 91), duke qene se ka kaluar nje periudhe e gjate prej 5 vjetesh, korrigjimi eshte bere ne menyre prespektive duke rregulluar tepricen e celjes te fitimive(humbje) te pashperndara (mbartura) per vleren e mesiperme. Shoqeria qe nga viti 2014 ka qene gjithmone me humbje, vlere e cila eshte me e madhe se te ardhurat qe duhej te paraqiteshin ne PASH ne vitin 2014, keshtu qe ky rregullim kontabel nuk sjell ndonje detyrim tatimor per shoqerine.

Shpenzime të personelit

	2,019 ALL	2,018 ALL
--	--------------	--------------



Paga dhe shpërblime		(1,440,000)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(240,480)
		(1,680,480)

# Shpenzime të tjera shfrytëzimi	2,019 ALL	2,018 ALL
Shpenzime auditimi		(120,000)
Shpenzime permbarimi		(38,000)
Sherbime bankare		(7,636)
Taksa vendore		(40,220)
Gjoba dhe demshperblime		(61,334)
Shpenz page per punonjesin qe ka fituar gjyqin		(1,677,500)
	0	(1,944,690)

ELBER Shpk

Shenime mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise

Per ushtrimin e mbyllur me 31.12.2019

# Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	2,019 ALL	2,018 ALL
Rezultati Ushtrimor	0	(3,655,170)
Humb.nga mosark.kerk.treteve		
Gjoba e penalitete /demshperblime	0	61,334
Shpenzime te panjohura per efekte fiskale		
Efekti i Korigjimeve te rezultatit Ushtrimor	0	61,334
Rezultati Tatimor	0	(3,593,836)
% e Tatim Fitimi	15%	15%
Tatimi Mbi Fitimin	0	0

NEVILA SADIKU

Hartuesi I Pasqyrave Financiare dhe Shenimeve Shpejguesese

LEDIA KOLLÇINAKU

Administratori

